



VENDIM

Nr.136, Datë 15.08.2016

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “KESH” SH.A. PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË ERE NR.111, DATE 01.07.2016 “MBI LËNIEN NË FUQI
TË VENDIMEVE NR.139, NR.141, N.145, NR.146, NR.147, NR.148, DATË
26.12.2014, TË BORDIT TË ERE-S PËR PËRIUDHËN
1 KORRIK 2016 - 31 DHJETOR 2016**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe nenit 16 të Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016, pasi shqyrtoi, relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a për rishikimin e vendimit të ERE nr.111, datë 01.07.2016 “Mbi lenien në fuqi të vendimeve nr.139, nr.141, n.145, nr.146, nr.147, nr.148, datë 26/12.2014, të Bordit të ERE-s për periudhën 1 Korrik 2016 - 31 Dhjetor 2016,

Konstatohet se:

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar bashkëngjitur ankimit, nuk rezultojnë të jetë paraqitur asnjë provë e re që të cojë Bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga Vendimi nr. 111 date 01.07.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendos:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “KESH” sh.a. për rishikimin e Vendimit të ERE nr.111, date 01.07.2016 “Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr.139, 141, n.145, nr.146, nr.147, nr.148, datë 26.12.2014, të Bordit të ERE-s për periudhën 1 Korrik 2016 - 31 Dhjetor 2016.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë KESH sh.a për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.